



SHOQATA KOMBËTARE E GJYQTARËVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë, më 17.11.2025

K Ë R K E S Ë

KËRKUES: Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr. 2160, datë 25.01.2008, me seli qendrore në Tiranë, me adresë elektronike njoftimi: engertp82@gmail.com, me Nr. Cel +355693301470, e përfaqësuar nga Kryetari i saj, Z. Engert Pëllumbi.

OBJEKTI: Ndërhyrja si subjekt i interesuar në procesin gjyqësor kushtetues me kërkues Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, subjekte të interesuara Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor si dhe me objekt – “Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 1 dhe 2 të ligjit nr. 33/2023 “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”” që parashikojnë: 1- “a) paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë e cila është e njëjtë me shumëzimin e koeficientit 0.36 me pagën e Presidentit të Republikës” dhe 2- “2. Për vitin 2023 paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë përllogaritet sipas këtij ligji nga data 1 prill duke u bazuar, për efekt të përllogaritjes, në pagën e Presidentit të Republikës me vlerë 425.000 (katërqind e njëzet e pesë mijë) lekë”.

BAZA LIGJORE: Neni 39, pika 1, shkronja “b”, e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, dhe neni 26, pika 2, e Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

DREJTUAR: Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Të nderuar zotërinj gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese!

Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, pas konsultimit me kalendarin e seancave gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, është vënë në dijeni se në datën

11.12.2025, ora 10:00, në këtë Gjykatë, do të zhvillohet seanca plenare publike me kërkues Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, subjekte të interesuara Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor si dhe me objekt – “Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 1 dhe 2 të ligjit nr. 33/2023 “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”” që parashikojnë: 1- “a) paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë e cila është e njëjtë me shumëzimin e koeficientit 0.36 me pagën e Presidentit të Republikës” dhe 2- “2. Për vitin 2023 paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë përllogaritet sipas këtij ligji nga data 1 prill duke u bazuar, për efekt të përllogaritjes, në pagën e Presidentit të Republikës me vlerë 425.000 (katërqind e njëzet e pesë mijë) lekë”.

Duke qenë se objekti i kësaj mosmarrëveshjeje kushtetuese prek drejtpërdrejt interesat e Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 39, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, dhe neni 26, pika 2, e Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, kjo Shoqatë kërkon që të ndërhyjë në këtë proces si subjekt i interesuar.

I. Legjitimimi i kërkuesit;

1. Kërkuesi, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë legjitimohet në këtë kërkim të saj in të paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për argumentet që do të renditen në vijim.

2. Në nenin 39, pika 1, shkronja “b”, e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “1. Pjesëmarrës në gjykimin kushtetues janë: ... b) Subjektet kundër të cilëve është paraqitur kërkesa ose që kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen që shqyrtohet.”, ndërsa në nenin 26, pika 2, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, përcaktohet se: “2. Në procesverbalin e votimit përcaktohet nëse shqyrtimi i çështjes do të bëhet në seancë plenare publike ose mbi bazë të dokumenteve, bazuar në interesin e gjykimit kushtetues dhe natyrën e çështjes. Po ashtu, në të përcaktohen edhe subjektet që do të thirren në gjykim, të cilat janë: subjektet kundër të cilave është paraqitur kërkesa ose që kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen që shqyrtohet; organi që ka nxjerrë aktin; çdo subjekt tjetër pjesëmarrja e të cilit vlerësohet e nevojshme për zhvillimin efektiv të gjykimit kushtetues.”

3. Në këtë kuadër, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë legjitimohet për të ndërhyrë në këtë proces pasi ajo është një subjekt që tërheq interesa të drejtpërdrejta nga kërkesa objekt gjykimi kushtetues, si një shoqatë e cila ka për qëllim mbrojtjen e statusit të gjyqtarëve, ndër të cilët dhe pjesë substanciale e tij, statusi material i tyre, që përfshin edhe atë financiar. Në këtë kuadër, Shoqata rezulton të jetë regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr. 2160, datë 25.01.2008, duke pasur si rrjedhojë personalitet juridik. Gjithashtu, ajo ka si objekt të veprimtarisë së saj: “Konsolidimin, forcimin dhe mbrojtjen e pavarësisë së gjyqtarëve dhe të sistemit gjyqësor në tërësi; Promovimin dhe inspirimin e vlerave të gjyqtarëve, në veçanti, dhe të sistemit gjyqësor në përgjithësi në Republikën e Shqipërisë, zhvillimin e profesionalizmit në gjyqësor, rritjen e

besueshmërisë së publikut tek gjyqësori dhe institucionet ndërkombëtare, zhvillimin dhe implementimin e statusit të gjyqtarëve në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me standardet ndërkombëtare në këtë fushë; Përmirësimin dhe zgjerimin e një rrjeti komunikimi midis gjyqtarëve, për të promovuar vlerat më pozitive brenda sistemit si dhe bashkëveprimin e këtij organizmi me organizmat ndërkombëtarë analoge, në shkëmbimin e eksperiencave midis tyre; Rritjen e rolit të gjyqtarëve në ushtrimin e funksionit të tyre kushtetues në dhënien e drejtësisë jashtë çdo lloji ndikimi; Krijimi i një instrumenti të posaçëm për bashkimin dhe përvijimin e mendimeve tekniko – juridike të gjyqtarëve për të gjitha aspektet e zhvillimit të sistemit të drejtësisë dhe të korpusit juridik në Republikën e Shqipërisë, reformimin e vazhdueshëm të sistemit të drejtësisë si një mjet i zhvillimit dinamik të jurisprudencës, në përputhje me të gjitha standardet ndërkombëtarisht të pranuar; Angazhimin për përmirësimin e kushteve të punës, ekonomike dhe të sigurisë fizike të gjyqtarëve si dhe të familjeve të tyre; Nxitjen dhe organizimin e seminareve, takimeve të ndryshme, me qëllim rritjen e nivelit profesional dhe performancës së gjyqtarëve; Organizimin dhe stimulimin e aktiviteteve profesionale të gjyqtarëve në të gjitha gjykatat si dhe aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare në këtë fushë; Mbështetjen dhe promovimin e gjyqtarëve të talentuar, duke bërë rekomandime para organeve kompetente kushtetuese; Shkëmbimin e eksperiencave kombëtare, rajonale, evropiane dhe më gjerë; Angazhimin dhe pjesëmarrjen në dhënien e mendimeve juridike, në lidhje me projektligjet që kanë të bëjnë me reformimin e sistemit gjyqësor; Mbrojtjen e sistemit gjyqësor në tërësi, duke ndërmarrë iniciativa për goditjen e ligjeve antikushtetuese, që kanë të bëjnë me këtë sistem apo statusin e gjyqtarëve, në Gjykatën Kushtetuese; Nxitjen dhe stimulimin e mendimeve juridiko – profesionale të gjyqtarëve nëpërmjet mundësisë së botimit të një reviste.” Sa më sipër, qartësisht rezulton se mbrojtja e statusit të magjistratit, në çdo dimension të tij, është objekt i veprimtarisë së Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë.

4. Lidhur me mënyrën e thirrjes së subjekteve që kërkojnë të ndërhyjnë në një gjykim kushtetues, edhe pse ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregullorja për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese përcaktojnë vetëm një kategori subjektësh të interesuar për këtë gjykim, ata “që kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen që shqyrtohet”, duke mos parashikuar ndërkaq mënyrën e thirrjes së tyre, me iniciativë të Gjykatës apo me kërkesë të vetë subjektit kur vihet në dijeni për çështjen që shqyrtohet, në nenin 1, pika 2, të ligjit organik të kësaj Gjykate si dhe në nenin 1, pika 2, të Rregullores në fjalë sanksionohet se dispozitat përkatëse plotësohen me parashikime të tjera ligjore, sipas natyrës së çështjes që shqyrtohet. Konkretisht, në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*” përcaktohet se: “*Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj apo nga Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes.*”, ndërsa në fjalinë e dytë të pikës 2, të nenit 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese parashikohet se: “*Për çështjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Rregullore, zbatohen dispozitat që rregullojnë procedurat civile, penale dhe administrative, sipas parashikimeve të kodeve përkatëse, duke pasur parasysh natyrën e çështjes konkrete në shqyrtim.*”

5. Në çështjen në shqyrtim, referuar natyrës së saj, dispozitat komplementare me ato të ligjit organik dhe Rregullores janë dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Ky Kod, në Kreun III, të Titullit II, normon pjesëmarrjen e personave të tretë në procesin civil, duke bërë edhe kategorizimin e tyre në ndërhyrës kryesorë dhe ndërhyrës dytësorë dhe tek kjo kategori e dytë, në ndërhyrje të detyrueshme dhe fakultative. Për nga pozita që paraqet Shoqata Kombëtare e Gjiqtarëve të Republikës së Shqipërisë në këtë rast, ajo shfaqet e ngjashme me një ndërhyrës dytësor, pasi interesat e saj i realizon nëpërmjet kërkuesit, Unionit të Gjiqtarëve të Shqipërisë.

6. Për sa i përket paraqitjes së kësaj kërkesë, Shoqata thekson se ajo u vu në dijeni për ekzistencën e gjykimit kushtetues të përmendur në pjesën hyrëse vetëm pas konsultimit me faqen zyrtare të internetit të Gjykatës Kushtetuese. Rezulton se seanca për shqyrtimin e kërkesës së Unionit të Gjiqtarëve të Shqipërisë është parashikuar për në datë 11.12.2025, ora 10:00, çfarë do të thotë se shqyrtimi gjyqësor nuk ka nisur ende dhe çështja është në fazën e shqyrtimit paraprak. Përtej kësaj, në praktikën e vet Gjykata Kushtetuese ka pasur raste kur ka pranuar kërkesën për të ndërhyrë jo vetëm si subjekt i interesuar por edhe si kërkues i mëvetëshëm pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor, bërjes së relatimit nga ana e gjyqtarit relator dhe dhënies së parashtrimeve nga palët, duke vendosur bashkimin me kërkesën fillestare që kishte iniciuar gjykimin kushtetues. Përmendim këtu kërkesën e bërë nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, i cili iu bashkua kërkesës së paraqitur nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë në gjykimin kushtetues me objekt: “*Shfuqizimi i VKM-së nr. 495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.*”, i përfunduar me vendimin nr. 70, datë 27.12.2023, të Gjykatës Kushtetuese.

7. Gjithashtu, nga pikëpamja formale, kërkesa është nënshkruar dhe paraqitur nga Kryetari i Shoqatës Kombëtare të Gjiqtarëve të Republikës së Shqipërisë, kompetencë e cila i përket këtij të fundi, referuar nenit 13 të Statutit. Në këtë dispozitë përcaktohet se: “*Kryetari i Shoqatës ka këto kompetenca: - Përfaqëson Shoqatën në marrëdhënie me të tretët;*”

8. Shoqata Kombëtare të Gjiqtarëve të Republikës së Shqipërisë paraqet këtë kërkesë për marrjen pjesë si subjekt i interesuar në gjykimin kushtetues të iniciuar nga Unioni i Gjiqtarëve të Shqipërisë për shkak të faktit se, edhe pse ajo legjitimohet *ratione personae* dhe *ratione materiae* për ta iniciuar vetë këtë proces, nuk legjitimohet *ratione temporis* në këtë drejtim, duke qenë se kjo kërkesë e saj është vënë në lëvizje jashtë afatit ligjor 2-vjeçar nga hyrja në fuqi e dispozitave të kundërshtuara, në kuptim të përmbajtjes së nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*”.

II. Rrethanat e çështjes;

9. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në vitin 2016 miratoi ndryshimet kushtetuese të lidhura me reformën në drejtësi, me synimin për të siguruar integritetin, llogaridhënien dhe efikasitetin në dhënien e drejtësisë për qytetarët, në përputhje me standardet më të mira evropiane. Pjesë e paketës ligjore është edhe ligji nr. 96/2016, datë 06.10.2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i cili ka për objekt përcaktimin e statusit të magjistratëve, duke parashikuar rregulla në lidhje me të drejtat e detyrimit e tyre, pranimin dhe emërimin, zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit, vlerësimin etik dhe

profesional, si edhe përgjegjësinë disiplinore, penale e civile. Në Pjesën II të këtij ligji rregullohen të drejtat dhe detyrimet e magistratëve, ndërsa në Kreun III të saj (nenet 11-22) rregullohen paga dhe përfitimet e tjera financiare dhe shoqërore.

10. Neni 11, pika 1, i ligjit nr. 96/2016, parashikon se paga e magistratit duhet të jetë në përputhje me dinjitetin e detyrës së tij dhe e përshtatshme për të garantuar pavarësinë dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e jashtme në ushtrim të funksionit. Në pikën 2 të këtij neni janë renditur këto kritere mbi bazën e të cilave caktohet paga e magistratit: a) shkalla e gjykatës ose prokurorisë ku magistrati ushtron funksionin; b) vjetërsia në ushtrimin e funksionit; c) fusha e veçantë e kompetencës lëndore në të cilën magistrati ushtron funksionin; ç) pozicioni drejtues.

11. Paga e magistratit caktohet sipas parashikimeve të nenit 12, i cili në pikën 5 përcakton elementet përbërëse të pagës mujore bruto, ku fillimisht renditeshin: a) paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, e cila ishte e njëjtë me “pagën për funksion” të punonjësve të shërbimit civil të kategorisë së parë, klasa e tretë, në pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri, ose me çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave; b) shtesa për pagën në grup, e cila është shuma që rezulton nga shumëzimi i pagës referuese bazë me koeficientin në përqindje, sipas funksionit që magistrati ushtron, referuar pikës 2 të këtij neni, përkatësisht: i) G1 90 për qind; ii) G2 98 për qind; iii) G3 106 për qind; c) shtesa për vjetërsi, e llogaritur mbi pagën referuese bazë, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni; ç) shtesa për pozicionin drejtues, e përcaktuar sipas parashikimeve të nenit 14 të këtij ligji; d) shtesa për vështirësi pune, sipas parashikimeve të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

12. Ligji nr. 96/2016, në nenin 169, që është dispozitë kalimtare, përcaktoi se Pjesa II, Kreu III, i këtij ligji, për pagat dhe përfitimet e tjera është e zbatueshme për magistratin, i cili kalon me sukses procesin e rivlerësimit, siç përcaktohet nga ligji “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por në asnjë rast jo më shpejt se data 01.01.2019. Përrjashtim nga ky rregull bëjnë magistratët në institucionet për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, të cilët përfitojnë pagat dhe përfitimet e tjera sipas këtij ligji, me caktimin në mënyrë të përhershme në këtë pozicion. Gjatë periudhës së rivlerësimit, për magistratin, i cili ende nuk është rivlerësuar, do të zbatohen parashikimet ligjore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji në lidhje me pagat dhe përfitime të tjera (pika 5). Gjithashtu, në këtë dispozitë përcaktohej edhe se magistrati që ka kaluar procesin e rivlerësimit pas datës 01.01.2019, gëzon të drejtën për të marrë diferencën mes pagës dhe përfitimeve të tjera, sipas parashikimeve ligjore të zbatueshme para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe pagës e përfitimeve të tjera, sipas parashikimeve të këtij ligji, brenda tre muajve nga vendimi i formës së prerë të rivlerësimit (pika 6).

13. Pas miratimit të ligjit, neni 169 i tij, është bërë objekt i kontrollit kushtetues mbi kërkesën e dy shoqatave të gjyqtarëve. Me vendimin nr. 34, datë 10.04.2017, Gjykata Kushtetuese (Gjykata), ndër të tjera, ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të pikës 5, fjalia e fundit, dhe pikës 6, të këtij neni, duke arsyetuar se “*ligjvënësi e ka kushtëzuar zbatimin e skemës së re të trajtimit financiar të magistratëve me dy kritere, që përfshijnë kalimin me sukses të procesit të rivlerësimit dhe plotësimin e një afati kohor i cili shtrihet deri në 1 janar 2019. Gjykata konstaton se deri në datën 1 janar 2019 magistratët do*

të vijojnë të përfitojnë pagë dhe përfitime të tjera në përputhje me parashikimet ligjore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, kurse pas datës 1 janar 2019 trajtimi financiar i tyre varet nga kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit, çka nënkupton se ata magjistratë që e kanë kaluar me sukses këtë proces gëzojnë të drejtën për të marrë diferencën mes pagës dhe përfitimeve të tjera para hyrjes në fuqi të ligjit me ato sipas këtij ligji, kurse për ata që ende nuk e kanë përfunduar atë proces, do të zbatohen parashikimet ligjore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji në lidhje me pagat dhe përfitimet e tjera (pika 5 e nenit 169). Në vështrim të sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se rregullimi ligjor i fjalisë së fundit të pikës 5 të nenit 196 dhe ai i pikës 6 të po këtij neni krijojnë kushtet për trajtim të pabarabartë të magjistratëve që ndodhen në kushte të njëjta, pa përlligje objektive dhe të arsyeshme. Për më tepër, Gjykata çmon se trajtimi financiar i pabarabartë i magjistratëve pas datës 1 janar 2019 nuk është mjeti i duhur për të përmbushur objektivin e ligjvënësit për të siguruar dinjitetin e profesionit dhe një pagë të përshtatshme si domosdoshmëri për të mbrojtur gjyqtarët nga ndërhyrje të jashtme të papërshtatshme.” (shih paragrafët 99-100 të vendimit nr. 34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

14. Paga e magjistratëve, sipas skemës së re të trajtimit financiar të përcaktuar në ligjin nr. 96/2016, ka filluar të zbatohet pas datës 01.01.2019. Në përlllogaritjen e pagës mujore të magjistratëve, elementi “pagës referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, e cila është e njëjtë me “pagën për funksion” të punonjësve të shërbimit civil të kategorisë së parë, klasa e tretë në pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri, ose me çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave”, ishte llogaritur sipas pikës 2 të VKM-së nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucioneve të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”. Konkretisht, ky element ishte llogaritur me vlerën 118,100 lekë, që përkon me elementin e pagës “shtesë për pozicion”, për kategorinë II-a, në lidhjen nr. 1 të VKM-së nr. 187/2017 dhe sipas terminologjisë së përdorur në këtë vendim nënkupton këtë element të pagës të përcaktuar për pozicionet e përfshira në klasën e dytë, kategoria e parë.

15. Në muajin tetor-nëntor të vitit 2020, Kontrolli i Lartë i Shtetit, mbi bazën e kërkesës së datës 13.10.2020 të KLGJ-së, ka kryer pranë kësaj të fundit një auditim tematik të përputhshmërisë, të ushtruar në bazë të autorizimit për verifikimin e përlllogaritjes së pagave, me fokus të veçantë, ndër të tjera, vjetërsinë në punë (për anëtarët jogjyqtarë të KLGJ-së), si dhe kuadrin ligjor e rregullator mbi të cilin mbështetet përlllogaritja. Në përfundim të këtij auditimi, me shkresën e datës 15.02.2021, KLSH-ja i ka dërguar KLGJ-së raportin përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin tematik. Në kuadër të masave organizative, për sa i përket përlllogaritjes së pagës së magjistratëve, KLSH-ja ka dhënë këtë rekomandim: “Për të gjithë magjistratët, pavarësisht nga pozicioni i tyre i punës (kategoritë G1, G2 dhe G3), paga referuese bazë të përlllogaritjet mbi bazën e plotë të pagës së drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri, e cila përbëhet nga paga e grupit, plus shtesën e pagës (132,100 = 14,000 + 118,100) dhe jo siç përlllogaritet aktualisht, vetëm mbi shtesën për pozicion (118,100). Paga duhet të bëhet duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (ose emërimin për

personat e punësuar pas kësaj date) dhe të përllogaritet për të gjithë periudhën, bashkë me të gjitha shtesat dhe pakësimet.”.

16. Në datën 11.03.2021 KLGJ-ja i është drejtuar Ministrisë së Financave me kërkesë për fonde buxhetore shtesë për vitin 2021, në funksion të përmbushjes së rekomandimit të KLSH-së. Ministria e Financave nuk e ka pranuar kërkesën, duke parashtruar arsyet në përgjigjen e datës 07.05.2021.

17. Në datën 23.03.2021, me nismën e një deputeti, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 50/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Mes të tjerash, me nenin 2, pika 1, të ligjit nr. 50/2021 është ndryshuar neni 12, pika 5, shkronja “a”, i ligjit nr. 96/2016, i cili kishte këtë përmbajtje: “a) paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, e cila është e njëjtë me vlerën e elementit “shtesa për pozicion” të pagës mujore të pozicionit drejtor i drejtorisë së përgjithshme apo të çdo pozicioni tjetër të barasvlershëm me të në Kryeministri. “Shtesa për pozicion” është elementi bazë i pagës mujore të nëpunësve civilë, nëpërmjet së cilës caktohet vlera e çdo vendi pune në shërbimin civil, pa u diktuar nga ndryshimet e pagës që shkaktohen nga rrethanat e posaçme ose individuale të vetë nëpunësit civil si vjetërsia apo shtesa për kushte pune. Për qëllimet e caktimit të pagës referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, “shtesa për pozicion” është i njëjti element i pagës si edhe elementi “paga bazë e kategorisë”, sipas përcaktimeve të ligjit për nëpunësin civil, apo me çdo lloj emërtimi tjetër që cakton elementin bazë të pagës mujore të pozicionit drejtor i drejtorisë së përgjithshme apo të çdo pozicioni tjetër të barasvlershëm me të në Kryeministri. Referimi i pagës mujore bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë me vlerën e elementit “shtesa për pozicion” ose “paga bazë e kategorisë” sipas përcaktimeve të mësipërme, nuk ka si qëllim të përcaktojë vlerën relative të funksioneve gjyqësore dhe të prokurorisë me pozicionet e punës në shërbimin civil ose të mundësojë klasifikimin e tij në kategorinë ose klasën përkatëse.”. Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 71, datë 14.05.2021, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit.

18. Pas këtij ndryshimi, rezulton se neni 12, pika 5, shkronja “a”, e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me nenin 2, pika 1, të ligjit nr. 50/2021, është bërë objekt kontrolli kushtetues mbi kërkesën e Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, pas shqyrtimit të kësaj mosmarrëveshjeje kushtetuese, me vendimin nr. 35, datë 22.11.2022, ka vendosur, ndër të tjera: “1. Pranimin e kërkesës. 2. Shfuqizimin e nenit 12, pika 5, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me nenin 2, pika 1, të ligjit nr. 50/2021, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. ...” Ky vendim është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 3, datë 09.01.2023, dhe ka hyrë në fuqi ditën e botimit.

19. Pas këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese dhe në përmbushje të detyrimeve që rridhnin prej tij, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka miratuar ligjin nr. 33/2023, datë 25.05.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Ky ligj ka hyrë në fuqi menjëherë. Në nenin 1 të tij parashikohet se: “Shkronja “a” e pikës 5 të nenit 12 ndryshohet si më poshtë: “a) paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, e cila është e njëjtë me shumëzimin e koeficientit 0.36 me pagën e Presidentit të Republikës. Paga referuese

bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë indeksohet me vendim të Këshillit të Ministrave jo më vonë se dy vjet nga indeksimi i fundit. Niveli i indeksimit në çdo rast nuk kalon një pikë përqindjeje mbi nivelin e targetuar të inflacionit nga Banka e Shqipërisë.”” Ndërkohë, në nenin 2 të këtij ligji përcaktohet se: “1. Paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë indeksohet për herë të parë nga Këshilli i Ministrave jo më herët se data 1.1.2026. 2. Për vitin 2023 paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë përllogaritet sipas këtij ligji nga data 1 prill, duke u bazuar, për efekt të përllogaritjes, në pagën e Presidentit të Republikës me vlerë 425000 (katërqind e njëzet e pesë mijë) lekë.”

20. Pas miratimit të ligjit në fjalë dhe në të njëjtën datë (25.05.2023), Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 34/2023 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, “për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar”. Në këtë ligj janë përcaktuar pagat e titullarëve të disa institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, ndër të cilët paga e Presidentit të Republikës, që nga 257.000 (dyqind e pesëdhjetë e shtatë mijë) lekë në muaj u bë 425.000 (katërqind e njëzet e pesë mijë) lekë në muaj. Ky ligj ka hyrë në fuqi menjëherë dhe i ka shtrirë efektet nga data 1 prill 2023.

21. Në të njëjtën kohë, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ka miratuar Vendimin nr. 325, datë 31.05.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, duke përcaktuar, ndër të tjera, pagat për kategoritë dhe klasat e pozicioneve të punës, si dhe vlerat mujore të shtesave të pozicioneve të nëpunësve civilë dhe nëpunësve disa të institucioneve. Ky akt nënligjor normativ është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 7, datë 15.01.2021 dhe ka hyrë në fuqi më 30.01.2021. Me hyrjen e tij në fuqi është shfuqizuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 26.06.2024, rezulton të jetë ndryshuar pjesërisht VKM-ja nr. 325, datë 31.05.2023, lidhur me strukturën dhe nivelin e pagave të administratës publike.

22. Rezulton se në datën 24.11.2022, është miratuar ligji nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”. Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 171, datë 21.12.2022, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në të, me efekte financiare që nga data 1 janar 2023.

III. Arsyetimi juridik;

23. Shoqata Kombëtare e Gjiqtarëve të Republikës së Shqipërisë çmon se dispozitat e kundërshtuara nga Unioni i Gjiqtarëve të Shqipërisë dhe, konkretisht, nenet 1 dhe 2 të ligjit nr. 33/2023 “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjiqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë””, vijnë në kundërshtim me garancitë e parashikuara në nenin 138 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë lidhur me statusin financiar të magjistratëve (gjiqtarëve).

24. Neni 138 i Kushtetutës parashikon: “Paga dhe përfitimet e tjera të gjiqtarit nuk mund të ulen, përveç rasteve kur: a) nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare; b) gjiqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit; c) i jepet një masë disiplinore ose vlerësohet i pamjaftueshëm profesionalisht, sipas ligjit.”.

25. Gjykata Kushtetuese ka pohuar se kjo normë kushtetuese përcakton një nga elementet përbërëse të statusit të gjyqtarit, pikërisht trajtimin financiar, pa të cilin nuk mund të garantohet ushtrimi i pavarur i funksionit. Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë, por edhe në elemente të tjera që burojnë nga ushtrimi i funksionit të tyre. Paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera janë ngritur në nivel kushtetues, me qëllim që të drejtat/përfitimet, të cilat burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, të mos ndryshohen me efekt negativ (*shih vendimet nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre (*shih vendimin nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo pavarësi, e parë në kontekstin e parimit kushtetues të shtetit të së drejtës, nuk është privilegj, por një nga detyrimet më të rëndësishme të gjyqtarëve dhe gjykatave që buron nga të drejtat e garantuara kushtetutshëmrisht individit që pretendon cenimin e të drejtave dhe lirive të tij, për të pasur një arbitër të paanshëm të mosmarrëveshjes, që do e zgjidhë atë në themel sipas Kushtetutës dhe ligjeve. Gjykata ka theksuar se parimi i pavarësisë së gjyqësorit përfshin një gamë të gjerë aspektesh, të cilat të marra së bashku krijojnë kushtet e nevojshme që gjykatat të përmbushin rolin dhe detyrat e tyre, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Garancitë kushtetuese që lidhen me palëvizshmërinë e gjyqtarëve, si dhe me paprekshmërinë e pagës e të përfitimeve të tjera, për shkak të funksionit, kanë ndikimin e tyre që gjyqtari të ushtrojë funksionin e tij në mënyrë të pavarur (*shih vendimet nr. 26, datë 24.07.2009; nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Për sa i përket nivelit të pagës, si një nga elementet me natyrë financiare të statusit të gjyqtarit, Gjykata ka theksuar se shteti ka detyrimin të vendosë paga të tilla, të cilat jo vetëm të jenë në përputhje me këtë status dhe atë të vetë pushtetit gjyqësor, funksionet e ushtruara dhe përgjegjësitë përkatëse, por edhe t'i mbrojnë gjyqtarët nga presionet që synojnë të influencojnë vendimet e tyre dhe, më në përgjithësi, sjelljen e tyre brenda juridiksionit të cilit i përkasin. Niveli i pagës duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar një pavarësi të vërtetë ekonomike dhe ajo nuk duhet të varet nga rezultatet e punës dhe nuk mund të ulet gjatë qenies së tij në detyrë (*shih vendimin nr. 26, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Siguria në lidhje me pagën dhe me ushtrimin e qëndrueshëm të detyrës krijon kushtet e nevojshme që gjyqtarët të zbatojnë ligjin në mënyrë të drejtë e të paanshme (*shih vendimet nr. 26, datë 24.07.2009; nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Duhet evidentuar se përmbajtja e nenit 138 të Kushtetutës është ndryshuar në vitin 2016, si pjesë e ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore që u përfshinë në paketën e Reformës në Drejtësi. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se parashikimi aktual, përveçse njeh dhe garanton në nivel kushtetues elementet më të rëndësishme të statusit të gjyqtarit, ka përcaktuar në mënyrë shteruese tre kritere që justifikojnë uljen e pagës dhe përfitimeve të tjera, ku kriteri i parë nuk lidhet me vullnetin ose sjelljen e gjyqtarit, kriteri i dytë është rrjedhë e ligjit (mbarimi i mandatit *ipso lege*), kurse kriteri i tretë lidhet ngushtësisht me sjellje/situata të tilla që përbëjnë shkelje disiplinore ose me cilësitë profesionale të magjistratit (pamjaftueshmëria profesionale) (*shih vendimin nr. 34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Nisur nga standardet kushtetuese të lartpërmendura, Gjykata Kushtetuese ka vërejtur se përmbajtja aktuale e nenit 138 të Kushtetutës jo vetëm që përcakton në mënyrë shteruese rastet e uljes së pagës dhe përfitimeve të tjera të gjyqtarit, por, për më tepër, në shkronjën “a”

të tij e përkufizon në mënyrë të shprehur arsyen publike të uljes së pagës dhe përfitimeve, duke e lidhur me nevojën e marrjes së masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare. Kjo dispozitë kushtetuese nuk parashikon delegim të shprehur për ligjvënësin për rregullimin e rasteve të tjera dhe as për arsyen publike të uljes së pagave dhe përfitimeve të gjyqtarit, si masë të përgjithshme, që do të thotë se këto dy çështje i përkasin rezervës absolute kushtetuese. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese ka vërejtur se në kushtet kur këto dy çështje për gjyqtarët, në ndryshim nga funksionarët e tjerë publikë ose nga individët, janë të rregulluara drejtpërdrejt në nivel kushtetues nga neni 138, në kontrollin kushtetues të respektimit të pagës dhe përfitimeve që rrjedhin nga statusi i tyre, nuk është e nevojshme analiza e kriterëve të kufizimit të nenit 17 të Kushtetutës ose të parimit të sigurisë juridike, në aspektin e pritshmërive të ligjshme (*shih vendimin nr. 35, datë 22.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se pjesë e paketës së reformës në drejtësi ishte, mes të tjerash, edhe rishikimi domethënës i sistemit të pagave, përfitimeve dhe shpërblimeve të tjera të magjistratit, me qëllim përmirësimin e trajtimit të tyre në përputhje me përvojën në punë, zhvillimin e karrierës dhe vështirësive. Sipas relacionit shpjegues të projektligjit nr. 96/2016, paga dhe trajtimi financiar i mëparshëm nuk mbanin parasysh në masë të mjaftueshme dinjitetin e detyrës e të profesionit, natyrën e përgjegjësive të funksionit gjyqësor, shkallën e vështirësive në përmbushjen e tij, numrin e lartë të papajtueshmërive dhe ndalimeve të posaçme për të kryer veprimtari të tjera që sjellin të ardhura, nevojën për ta mbrojtur nga presionet dhe ndikimet në veprimtarinë e tij gjyqësore e në sjelljen e tij në tërësi, si dhe nevojat e integritit social të tij dhe të familjes në shoqëri. Kuadri i ri kushtetues e ligjor, duke parashikuar rritjen domethënëse të përfitimeve të magjistratit, synoi të ofrojë një skemë reale dhe dinjitoze të shpërblimit të magjistratit dhe garantimin e një pagë që i korrespondon dinjitetit të profesionit dhe përgjegjësive të detyrës. Objektivi i mësipërm i ligjvënësit është sanksionuar në nenin 11 të ligjit nr. 96/2016, ku parashikohet se paga e magjistratit dhe përfitimet e tjera financiare duhet të jenë në përputhje me dinjitetin e detyrës së magjistratit dhe të përshtatshme për të garantuar pavarësinë dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e jashtme në ushtrim të funksionit të tij (*shih vendimin nr. 34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Rëndësia e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, e lidhur kjo pazgjidhshmërisht me paprekshmërinë e pagës, si element substancial i statusit të gjyqtarëve, është përmendur gjerësisht edhe në një sërë dokumentesh ndërkombëtare si dhe në jurisprudencën e gjykatave evropiane.

31. Në Rekomandimin e tij CM/Rec(2010)12 të datës 17 nëntor 2010 mbi pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës vërejt (pikat 53 dhe 54) se rregullat kryesore të sistemit të shpërblimit për gjyqtarët profesionistë duhet të përcaktohen me ligj; se shpërblimi i gjyqtarëve duhet të jetë në përputhje me profesionin dhe përgjegjësitë e tyre dhe të jetë i mjaftueshëm për t'i mbrojtur ata nga nxitjet që synojnë të ndikojnë në vendimet e tyre; **dhe se dispozita specifike ligjore duhet të futen si një mbrojtje kundër një uljeje të shpërblimit që synon posaçërisht gjyqtarët.**

32. Në Raportin e tij mbi Pavarësinë e Sistemeve Gjyqësore, të miratuar më 12-13 mars 2010, Komisioni Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit ("Komisioni i Venecias") ishte i mendimit (paragrafët 51-53) se, në lidhje me gjyqtarët, një nivel shpërblimi duhet të garantohet me ligj dhe se edhe në kohë krize, funksionimi i duhur dhe pavarësia e gjyqësorit nuk duhet të

rrezikohen; gjykatat nuk duhet të financohen në bazë të vendimeve diskrecionare të marra nga organet zyrtare, por në një mënyrë të qëndrueshme në bazë të kritereve objektive dhe transparente.

33. Në Mendimin e saj Amicus Curiae për Gjykatën Kushtetuese të “Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë” në lidhje me ndryshimet në disa ligje që lidhen me sistemin e pagave dhe shpërblimeve të zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të miratuar më 17-18 dhjetor 2010, Komisioni i Venecias vërejt (në paragrafin 20) se në mungesë të një ndalimi të shprehur kushtetues, një ulje e pagave të gjyqtarëve, në situata të jashtëzakonshme dhe në kushte specifike, mund të justifikohet dhe nuk do të konsiderohet si shkelje e pavarësisë së gjyqësorit. Në vendimin e uljes të pagave të gjyqtarëve të diktuar nga një krizë ekonomike, duhet t'i kushtohet vëmendje e duhur çështjes nëse shpërblimi i tyre vazhdon të jetë në përputhje me dinjitetin e profesionit të një gjyqtari dhe barrën e tij ose të saj të përgjegjësisë dhe nëse përputhet me kërkesën që ky shpërblimi të jetë i përshtatshëm.

34. Nga ana e saj, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ka theksuar se, ashtu si mbrojtja kundër shkarkimit nga detyra të anëtarëve të organit përkatës gjyqësor (shih vendimin e 19 shtatorit 2006, Wilson, C-506/04, paragrafi 51), marrja nga këta anëtarë e një niveli shpërblimi në përputhje me rëndësinë e funksioneve që ata kryejnë përbën një garanci thelbësore për pavarësinë gjyqësore (shih vendimin e 27 shkurtit 2018, Associação Sindical dos Juizes Portugueses, C-64/16, paragrafi 45).

35. Në konfirmim të këtyre standardeve kushtetuese dhe ndërkombëtare lidhur me pavarësinë e gjyqtarëve, element i të cilit është padyshim paga e tyre, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve thekson se Kuvendi i Republikës së Shqipërisë nuk i ka përmbushur plotësisht orientimet e dhëna nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 35, datë 22.11.2022, me të cilin ajo shfuqizoi, ndër të tjera, nenin 12, pika 5, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me nenin 2, pika 1, të ligjit nr. 50/2021, si i papajtuështëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Në paragrafin 104 dhe të fundit të këtij vendimi, i cili përbën konkluzionin dhe sintezën e të gjithë arsyetimit të tij, Gjykata Kushtetuese ka theksuar: *“104. Gjykata vlerëson të theksojë se ligjvënësi, brenda hapësirës së tij normuese, në formulimin e normës së re ligjore për pagën e magjistratit ka diskrecionin t'i referohet formulës aktuale të referencës në shërbimin civil ose çdo formulë tjetër që referon në legjislacionin në fuqi për pagat e funksionarëve publikë, duke qenë kjo një çështje që i përket oportunitetit të tij. Megjithatë, në ushtrim të kompetencave të tij, në plotësimin e kuadrit ligjor ai duhet të mbajë parasysh përcaktimet e nenit 138 të Kushtetutës, duke garantuar, në çdo rast, që paga dhe përfitimet e tjera që vijnë si rrjedhojë e zbatimit të sistemit të referencës së pagave, të mos ulen nën standardin e analizuar në këtë vendim, përveçse kur verifikohet përjashtimi i nenit 138, shkronja “a”, të Kushtetutës.”*

36. Në pamje të parë duket sikur Kuvendi e ka respektuar standardin e vendosur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj të mësipërm, pasi nga paga referuese prej 152.700 (njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind) lekë që përcaktohej në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar me VKM-në nr. 621, datë 28.09.2022, për klasën I, kategoria I-b, me ligjin nr. 33/2023, objekt shqyrtimi, paga referuese u përcaktua në 153.000 (njëqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekë. Në këtë kuadër, u duk sikur Kuvendi zbatoi rekomandimet detyruese të Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj nr. 35, datë 22.11.2022.

Megjithatë, sikurse do të analizohet në vijim, Kuvendi, në këtë rast, ka vepruar me keqbesim dhe në kundërshtim me standardet e vendosura në vendimi e sipërcituar.

37. Rezulton se miratimi i ligjit nr. 33/2023 u bë në datën 25.05.2023, me efekte financiare që nga data 1 prill 2023. Në të njëjtën datë rezulton të jetë miratuar edhe ligjit nr. 34/2023, për pagat në institucionet kushtetuese dhe institucionet e tjera të pavarura, të krijuara me ligj, i cili gjithashtu i shtriu efektet financiare që nga data 1 prill 2023. Nga ana tjetër, në datën 31.05.2023 u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 325, për strukturën dhe nivelet e reja të pagave në administratën publike, i cili po ashtu efektet financiare i shtriu që nga data 1 prill 2023. Kjo do të thotë se Kuvendi i kishte marrë tashmë masat me buxhetin e vitin 2023 për të përballuar rritjen e pagave në sektorin publik, duke përfshirë pagat e administratës publike, pagat e institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj, por edhe pagat e magjistratëve. Rezulton që vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 35, datë 22.11.2022, të ketë hyrë në fuqi në datën 09.01.2023, pas botimit të tij në fletore zyrtare dhe, çuditërisht, pas miratimit të ligjit nr. 84/2022, datë 24.11.2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, i cili i ka sjellë efektet financiare që nga data 1 janar 2023, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 33/2023, në datën 25.05.2023, duke ulur ndërkaq shtesën e pagës që kishte parashikuar më parë për gjyqtarët (magjistratët) në buxhetin e vitit 2023.

38. Arrihet në këtë përfundim pasi nëse në këtë historik të akteve ligjore dhe gjyqësore do të mungonte vendimi nr. 35, datë 22.11.2022, i Gjykatës Kushtetuese, atëherë me skemën e vjetër të pagave të magjistratëve, në vitin 2023 ata do të pësonin një rritje të konsiderueshme të pagës së tyre referuese, në raport me rritjen e që do të kishte kategoria përkatëse e pagës që i korrespondon drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri, ose çdo pozicioni tjetër të barasvlershëm me të. Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, pozicioni i barasvlershëm me drejtorin e drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri sot është pozicioni i drejtorit të Departamentit në Kryeministri, që i korrespondon kategorisë I, klasa I-2. I njëjti pozicion (ai i drejtorit të Departamentit në Kryeministri) është përdorur si standard minimal për të përlllogaritur pagën referuese të gjyqtarëve sipas vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese.

39. Pra, në rast se gjyqtarët nuk do kërkonin të drejtën e tyre kushtetuese për të pasur një pagë të përlllogaritur sipas interpretimit kushtetues të ligjit, çka cenonte statusin e tyre financiar, e lidhur me pavarësinë në ushtrimin e funksionit, atëherë ata sot, sipas përlllogaritjeve të Kuvendit, do të kishin një pagë më të lartë se paga aktuale, me një shtesë në pagën referuese prej 52.000 (pesëdhjetë e dy mijë) lekësh (kategoria I, klasa I-3) ose 34 %, si pasojë e miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023, i ndryshuar me VKM-në nr. 421, datë 26.06.2024. Me pak fjalë, gjyqtarët u ndëshkuan për shkak se ushtruan një të drejtë kushtetuese.

40. Një tjetër aspekt shumë i rëndësishëm dhe që ka të bëjë me statusin financiar të gjyqtarëve, që nuk është marrë në konsideratë nga Kuvendi në miratimin e ligjit nr. 33/2023 është ai që çdo formulë e zgjedhur nga ky organ (Kuvendi) duhet të ndjekë një raport të drejtë me pagën e administratës publike.

41. Neni 138 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili është miratuar si pjesë e paketës së Reformës në Sistemin e Drejtësisë dhe që konsiderohet si dispozita “guaskë” e statusit financiar të magjistratit, është zbërthyer më tej me parashikimin e nenit 22 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, edhe kjo e fundit e përmbajtur në një ligj që bën pjesë në paketën e së njëjtës reformë. Të dy këto akte, si amendamentet kushtetuese që përfshijnë, ndër të tjera, nenin 138 të saj, ashtu edhe ligji nr. 96/2016 janë bashkëkohës dhe përshtohen nga e njëjta logjikë normative (*ratio legis*).

42. Neni 22 i ligjit nr. 96/2016, përcakton se: “1. Paga dhe përfitimet e tjera të magjistratit nuk mund të ulen, me përjashtim të rasteve kur: a) ka situata të vështira financiare në vend ose emergjenca të tjera kombëtare, duke marrë parasysh faktorët si vijon: **një mospërputhje e qartë midis dinamikës së pagave të magjistratëve dhe dinamikës së pagave standarde në shërbimin civil; indeksi i pagesave, ashtu si dhe indeksi i çmimeve të konsumatorit. Këta faktorë është e nevojshme që të vlerësohen, për të gjetur balancën mes paprekshmërisë së pagës dhe nevojës për të shmangur marrjen e borxheve të reja; b) magjistrati ushtron të drejtën për t’u kthyer nga një pozicion i mëparshëm më i lartë ose më i specializuar ose me mandat të kufizuar dhe me pagesë më të lartë; c) magjistrati ka masë disiplinore; ç) vlerësohet i pamjaftueshëm ose jepet masa disiplinore e uljes së përkohshme të pagës, sipas parashikimeve të këtij ligji. 2. Magjistrati duhet të kthejë shumat e përfituara të pagës ose përfitimeve financiare nëse ka përfituar më shumë sesa është parashikuar në ligj.” Nga përmbajtja e kësaj dispozite nxjerrim përfundimin se paga e magjistratëve, në përcaktimin e nivelit të saj, përveç garantimit të dinjitetit të profesionit dhe kompensimit të kufizimeve të tij, ndër të tjera, duhet të mbajë në konsideratë raportin e saj të drejtë me pagat standarde në shërbimin civil dhe indeksin e çmimeve të konsumatorëve.**

43. Me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023, ky raport i drejtë i përcaktuar më parë sipas nenit 12 të ligjit nr. 96/2016, i cili referonte pikërisht në pagat e administratës publike, u prish, pasi pagat e kësaj të fundit u rritën në një mënyrë të konsiderueshme, ku paga e mëparshme referuese e magjistratëve (klasa I, kategoria I-b që tashmë i përket kategorisë I, klasa I-2) u rrit me 78.300 (shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind) lekë ose me 56,45 %, të saj ndërkohë që paga referuese e magjistratëve mbeti pothuaj e pandryshuar, duke u rritur me vetëm 300 (treqind) lekë. Gjithashtu, edhe në tërësi pagat e administratës publike u rritën me një përqindje të konsiderueshme. Rezulton se ato pësuan një rritje tjetër edhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 26.06.2024. Ndërkohë, me miratimin e ligjit nr. 34/2023 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9584, datë 17.7.2006, “për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar”, rezulton se edhe pagat e disa institucioneve kushtetuese dhe të pavarura, të krijuara me ligj u rritën ndjeshëm, ku theksojmë se paga e Presidentit të Republikës u rrit me 65 %. Gjithsesi, duhet të theksojmë se kjo rritje u bë pas më shumë se dy dekadash në pagat e këtyre funksionarëve dhe, për shkak të natyrës së funksionit që ata ushtrojnë, nuk realizohet në periodicitetin që ndodh për pagat e administratës publike.

44. Ky është një tjetër faktor që dëmton përditësimin e pagave të magjistratëve nëse referenca bëhet tek këta funksionarë, pa pasur një mekanizëm korrigjues që do të ndiqte trendin e rritjes së përgjithshme të nivelit të pagave në vend dhe rritjes së indeksit të çmimeve. Indeksi i pagës në periudha periodike përben një mekanizëm të mirëpritur, që synon të zbusë

në një farë mënyre efektet e inflacionit por megjithatë është i pamjaftueshëm për të ndjekur rritjen ekonomike dhe rritjen e nivelit të përgjithshëm të pagave.

45. Rritja e madhe e pagave në sektorin publik, me përjashtim të magjistratëve, u bë për dy arsye. Së pari, rritja e lartë shkallës së inflacionit për shkak të ngjarjeve ndërkombëtare që përbëjnë fakte të njohura botërisht, si pandemia e Covid 19 dhe lufta në Ukrainë, si dhe rritja e ndjeshme e ekonomisë, me reflektim në rritjen e buxhetit të shtetit. Megjithatë, këto dy arsye nuk u reflektuan në rritjen e pagave të magjistratëve. Jo pa qëllim kushtetutëbërësi dhe ligjvënësi kanë parashikuar që paga e magjistratit duhet të reflektojë dinamikën e pagave në shërbimin civil, duke përfshirë jo vetëm rastin e uljes në situatë krize por edhe rritjen në situatë lulëzimi ekonomik, si dhe indeksin e çmimeve të konsumatorit. Pra, pavarësisht formulës që zgjedh ligjvënësi në përcaktimin e pagave të magjistratëve, e cila është në diskrecionin e tij, sikurse edhe Gjykata Kushtetuese e ka cituar në vendimin e saj nr. 35, datë 22.11.2022, ai duhet në çdo rast të reflektojë këto dy kritere, çka nuk e ka bërë në situatën konkrete. Rezulton se tashmë paga referuese e gjyqtarëve është e përafërt me kategorinë II, klasa II-2, çka është shumë më e ulët se referenca e mëparshme tek kategoria I, klasa I-2, tek sistemi i pagave të nëpunësve civilë.

46. Edhe pse me miratimin e strukturës dhe nivelit të ri të pagave të magjistratëve si pjesë e paketës së Reformës në Drejtësi u prish hierarkia e pagave në vend, si një normë e pashkruar por e gjithëpranuar, duke tejkuluar pagat e magjistratëve ato të funksionarëve më të lartë në vend, si Presidenti i Republikës dhe Kryeministri, kjo mund të ndreqej duke rritur pagat e këtyre të fundit dhe jo duke ulur *de facto* pagat e magjistratëve, raporti i të cilave, pavarësisht formulës së përdorur, duhet të ruajë të njëjtën diferencë me pagat e shërbimit civil.

47. Për çka u tha më sipër, me miratimin e ligjit nr. 33/2023 “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”” ligjvënësi praktikisht ka ulur pagat e magjistratëve, si në vlerë absolute me atë që kishte parashikuar në buxhetin e vitit 2023, ashtu edhe në vlerë relative, në raport me pagat e tjera në sektorin publik, të cilat kanë pësuar një rritje të ndjeshme gjatë vitit 2023, duke qenë kjo masë ligjore një diskriminim për magjistratët. Theksojmë se në këtë rast nuk jemi përpara situatës përjashtimore të parashikuar nga shkronja “a”, e nenit 138 të Kushtetutës dhe, për këtë shkak, masa e ndërmarrë nga ligjvënësi është antikushtetuese.

48. Për çka u tha më sipër, Gjykata Kushtetuese duhet të pranojë kërkesën e bërë nga Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë dhe të shfuqizojë dispozitat e ligjit nr. 33/2023 “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë””, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

PËR SHOQATËN KOMBËTARE TË GJYQTARËVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**KRYETARI
ENGERT PËLLUMBI**